



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 shkurt 2013
Nr. ref.:RK381/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI24/11

Parashtrues

Ali Buzhala

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren,
Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar

Kërkesa

1. Kërkesën e ka parashtruar Ali Buzhala, nga fshati Budakovë, komuna e Suharekës (parashtruesi i kërkesës). Në procedurë, në Gjykatë, parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Gafurr Elshani, avokat nga Prishtina.

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011, me të cilin iu refuzua, si e pabazuar, ankesa në çështjen juridike përmbartimore përkitazi me përmbartimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM).
3. Parashtruesi i kërkesës pohon se është shkelur neni 49, pika 1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta); neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] i Kushtetutës; dhe neni 6, në lidhje me nenin 13, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-121), të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 shkurt 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 2 mars 2011, Kryetari e emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 24 gusht 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren u përgjigj duke dorëzuar në Gjykatë disa dokumente, që të gjitha këto dokumente tashmë ishin të bashkëngjitura në kërkesë.
8. Më 9 nëntor 2011, Gjykata e njoftoi KPM-në për kërkesën.
9. Më 23 nëntor 2011, KPM-ja iu përgjigj Gjykatës duke theksuar faktet procedurale dhe historikun e rastit, si dhe ia dorëzoi Gjykatës disa dokumente, të cilat po ashtu tashmë i ishin bashkëngjitur kërkesës.
10. Më 9 dhjetor 2011, Gjykata kërkoi informata shtesë nga përfaqësuesi i parashtruesit, përkitazi me "padinë e parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës, nr. 193/7, të 8 qershorit 2010". Më 1 shkurt 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi "që të dorëzonte në Gjykatën Kushtetuese një kopje të kërkesës, si dhe çdo dokumentacion tjetër gjyqësor që ndërlidhet me procedurën në Gjykatën Supreme".
11. Më 11 maj 2012, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Supreme, përkitazi me statusin e procedurës në Gjykatën Supreme të rastit Nr. 193/07.
12. Më 30 maj 2012, Gjykata Supreme informoi se "sipas regjistrave të kësaj Gjykate, nuk figuron se z. Buzhala ka lëndë në këtë Gjykatë me Nr. 139/07".
13. Më 4 korrik 2012, KPM-ja u përgjigj për herën e dytë dhe i ofroi Gjykatës dokumente që i kishte bashkëngjitur edhe në përgjigjen e parë.

14. Më 4 korrik 2012, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës, i dërgoi Gjykatës Kushtetuese tërë dosjen e lëndës përkîtazi me kontestin e z. Ali Buzhalës.
15. Më 15 korrik 2012, Kryetari e emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova anëtare të Kolegjit shqyrtues, në zëvendësim të gjyqtarës Gjyljeta Mushkolaj.
16. Më 12 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Kontrata e punësimit

17. Më 19 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës filloi marrëdhënien e punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejme: MBPZHR), si drejtor i Drejtorisë Koordinuese në Prizren. Kontrata e punësimit ishte e vlefshme për një vit, pra deri më 19 nëntor 2009.
18. Më 11 qershor 2009, MBPZHR (Vendimi KE-344/09), për shkak të “shkeljeve të rënda të detyrave dhe dispozitave ligjore”, e suspendoi parashtruesin e kërkesës “me pagesë (...) deri sa të merrej një vendim tjetër nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural”.
19. Më 18 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi (KE-344/09, të 11 qershorit 2009) te Kryeshefi Ekzekutiv i MBPZHR-së, për shkak “të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe të fakteve, si dhe për shkak të shkeljes së dispozitave materiale”, duke propozuar “anulimin e vendimit të kundërshtuar”.
20. Më 21 gusht 2009, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë (Nr. 02/178/2009) në KPM, duke kundërshtuar vendimin për suspendim dhe duke pohuar se vendimi ishte arbitrar, drastik dhe i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

Vendimet në procedurën administrative

21. Më 8 shtator 2009, KPM nxori Vendim (A 02/178/2009) me të cilin e obligoi MBPZHR-në që të fillonte procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës, ashtu siç theksohet në Vendimin për suspendim KE-344/09, e 11 qershorit 2009.
22. Më 13 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë të re (Nr. 02/216/09) në KPM kundër Vendimit (nr. ref. KE-344/09, të 11 qershorit 2009) për suspendim nga puna.
23. Më 4 dhjetor 2009, KPM-ja e miratoi ankesën e parashtruesit (Vendimi A. 02/216/2009), me ç'rast “e anuloi Vendimin e Organit të Punësimit nr. KE-344/09, e 11 qershorit 2009” dhe “e obligoi Organin e Punësimit që t’ia mundësojë ankuesit

kthimin në punë dhe realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit”.

24. Ndërkohë, më 30 nëntor 2009, Komisioni Disiplinor i MBPZHR-së nxori Vendim (Nr. 1541/09) me të cilin e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe ia shqiptoi masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës.
25. Më 22 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Komisionin e Ankesave të MBPZHR-së kundër vendimit të Komisionit disiplinor.
26. Më 28 prill 2010 dhe, sërish, më 4 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua sërish në KPM, pasi që MBPZHR-ja nuk e kishte përmbaruar vendimin e KPM-së për kthimin e tij në vendin e punës.
27. Më 30 prill 2010, KPM-ja e njoftoi parashtruesin e kërkesës se e kishte informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës se vendimi i KPM-së nuk po përmbarohej dhe e udhëzoi parashtruesin që të shfrytëzonte procedurat gjyqësore për përmbarimin e vendimit të saj.

Procedura në Gjykatën Komunale në Prizren

28. Më 6 maj 2010, parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarimin e vendimit të KPM-së.
29. Më 21 maj 2010, Gjykata Komunale në Prizren mori vendim për lejimin e përmbarimit të kërkuar.
30. Më 16 korrik 2010, MBPZHR-ja parashtrroi kundërshtim “ndaj aktvendimit E. nr. 942/10 të Gjykatës Komunale në Prizren, të 21 majit 2010”.
31. Më 27 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi përgjigje në kundërshtimin e MBPZHR-së, duke propozuar që “Gjykata të hedhë poshtë kundërshtimin e debitorit si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin përmbarimor”.
32. Më 2 shtator 2010, Gjykata Komunale në Prizren (E. nr. 942/2010) nxori vendim me të cilin “e miratoi si të bazuar kundërshtimin e debitorit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë Pyjore të Kosovës, Drejtorisë Koordinuese në Prizren, të parashtruar kundër aktvendimit të gjykatës për lejimin e përmbarimit të Aktvendimit E. nr. 942/10, të 21 majit 2010” dhe “pezulloi procedurën lidhur me këtë çështje juridike dhe aktvendimin e Gjykatës për lejimin e përmbarimit të Aktvendimit E. nr. 942/10, të 21 majit 2010, si dhe të gjitha veprimet e tjera procedurale të ndërmarra deri më tani në këtë çështje juridike”.

Procedura në Gjykatën e Qarkut në Prizren

33. Më 18 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër vendimit të Gjykatës Komunale, “për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”.
34. Më 20 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori vendim me të cilin “e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e ushtruar nga ankuesi, Ali Buzhala (...) dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, E. nr. 492/2010, e 2 shtatorit 2010”.
35. Më 4 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës i paraqiti kërkesë Prokurorit Publik të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit përmbarimor të Gjykatës Komunale në Prizren, E. nr. 942/10, të 2 shtatorit 2010, dhe aktvendimit përmbarimor të shkallës së dytë, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011.
36. Më 9 shkurt 2001, Zyra e Prokurorit “vërtetoi se nuk gjeti bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (...)”.

Rasti në procedurë e sipër në Gjykatën Supreme

37. Më 15 dhjetor 2011, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e informoi Gjykatën se “Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vendosur ende në lëndën nr. 193/07”.
38. Më 14 shkurt 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës u përgjigj se “lënda në Gjykatën Supreme, me numër të lartcekur, ka të bëjë me çështje dhe vendime që janë ngritur pas titullit përmbarues”.
39. Më 7 korrik 2012, Agjencia Pyjore e Kosovës i dorëzoi Gjykatës një kopje të përgjigjes përkitazi me lëndën nr. 193/7, të 8 qershorit 2010, ku parashtruesi i kërkesës është paditës në procedurë në Gjykatën Supreme.
40. Dokumentacioni i dorëzuar tregon se procedura e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme ende nuk ka përfunduar.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

41. Kushtet e pranueshmërisë janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

43. Nga ana tjetër, neni 47.2 i Ligjit, po ashtu, përcakton:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

44. Përveç kësaj, rregulli 36.1.a i Rregullores, parasheh:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimin të kundërshtuar”.

45. Në këtë rast, vërehet se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, pasi që ende nuk ka përfunduar procedura në Gjykatën Supreme.

46. Në të vërtetë, siç u përmend më lart, avokati i parashtruesit të kërkesës, më 15 dhjetor 2011, e informoi Gjykatën se procedura në Gjykatën Supreme, në çështjen e parashtruesit të kërkesës përkitazi me të drejtën e punës, ende nuk ka përfunduar.

47. Prandaj, në këto rrethana, kur një çështje është në procedurë e sipër në Gjykatën Supreme, Gjykata Kushtetuese nuk është në gjendje të procedojë më tej me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës. Rezulton që kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.

Përfundim

48. Nga sa u tha më lart, Gjykata gjen se kërkesa nuk i plotëson kushtet nga neni 113.7 i Kushtetutës; nga neni 47.2 i Ligjit; dhe nga rregulli 36.1.a i Rregullores së punës; dhe, si e tillë, është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 47.2 të Ligjit; dhe në mbështetje të rregullit 36.1.a të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani